



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 58

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHOYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25
JANAR 2025**

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19 - 25 janar 2025, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 23.1.2025, ora 08.30, me tematikë “Tjetër”, “Çështje sociale”, “*Trajnim i mesimëdhënies të Shkollave të*

Data: 31.1.2025 Nr: 58
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

Mesme Profesionale dhe instruktoreve të Qendrave të Formimit Profesional për ofrimin e kurrikulës "Aftësi për Punësim".

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t'i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *"Me vullnetin për të qenë korrekt në raportim Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive raportoi jashtë afatit një aktivitet i cili nuk ishte publik, por një trajnim i disa anëtarëve të stafeve të shkollave të mesme profesionale. Ky trajnim ishte në vijim të një trajnimi katër ditor me temë "Ofrim i kurrikulës Aftësi në Punësim", të zhvilluar në muajin nëntor dhe një takimi online të mbajtur më 15 janar. Ky aktivitet nuk është publikuar në media, rrjete sociale dhe nuk kishte asnjë të ftuar, pra nuk ka qenë i hapur për publikun".*

Për sa më sipër, referuar të dhënave të paraqitura në ndërfaqen e raportimeve si dhe pretendimeve të dhëna nga personi përgjegjës për raportim, veprimtaria nuk ka qenë e hapur për publikun dhe nuk ka pasur pjesëmarrje të medias.

Në përfundim të shqyrtimit, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se për shkak të tematikës dhe natyrës së aktivitetit, veprimtaria nuk përbën një veprimtari publike në kuptim të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe nuk mbart detyrimin për t'u raportuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja "n", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI